



KONKURS PËR PUNË

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), është duke kërkuar një kandidat të motivuar që t'i bashkohet ekipit tonë në pozitën:

Zyrtar i Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde (DMCPS)

Detyrat dhe përgjegjësitë

Zyrtari i Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde (MCPS) do të jetë personi përgjegjës mbi mbarëvajtjen dhe zhvillimin e DMCPS. Zyrtari është përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planit vjetor të MCPS, duke përfshirë organizimin e rishikimeve të auditorëve dhe kontabilistëve. Zyrtari poashtu përgatit raporte individuale për auditorët/kontabilistë dhe për Komisionin e Cilësisë të ShKÇAK, si dhe zhvillon sesione të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional për anëtarët. Gjithashtu, ai mbikëqyr avancimin profesional të anëtarëve dhe bashkëpunon me departamente të tjera për të arritur qëllimet e ShKÇAK.

- Përgatit dhe implementon planin vjetor për MCPS i cili përfshinë listën e auditorëve dhe kontabilistëve, kohën e kontrollit dhe numrin dosjeve të auditimit/kontabilitetit të cilat do të kontrollohen gjatë periudhës përkatëse;
- Realizon menaxhimin e cilësisë në pajtueshmëri me planin vjetor, përgatit raportet individuale të cilat i dërgohen auditorëve/kontabilistëve si dhe raportin e përgjithshëm i cili i dërgohet Komisionit të Cilësisë të ShKÇAK;
- Zhvillon si dhe bënë implementimin e sesioneve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) për anëtarët në lidhje me MCPS;
- Përkujdeset për të siguruar avancimin e anëtarëve në fushën e zbatimit të standardeve profesionale përmes komunikimit të vazhdueshëm;
- Bashkëpunon dhe qëndron në komunikim të vazhdueshëm me partnerët e ShKÇAK të fushës së MCPS;
- Bashkëpunon me departamentet tjera në realizimin e misionit, vizionit dhe qëllimeve të ShKÇAK si dhe detyra dhe përgjegjësi tjera sipas kërkesës;
- Raporton te Eksperti për MCPS, Drejtori Ekzekutiv dhe/ose Zëvendës Drejtori mbi realizimin e objektivave dhe zhvillimin e aktiviteteve dhe punëve të paracaktuara.

Kualifikimet dhe përvoja:

- Bachelor ose master në Ekonomi;
- Preferohet të jetë i çertifikuar në ShKÇAK ose në ndonjë shoqatë tjetër profesionale të njohur ndërkombëtarisht;
- Përvojë të punës në auditim të pasqyrave financiare dhe zbatim të standardeve profesionale të kontabilitetit dhe auditimit;
- Aftësi të mira komunikuese, punës në ekip dhe i/e gatshëm për punë nën presion;
- Njohja e gjuhës angleze është e domosdoshme;
- Njohuri në kompjuter (Excel, Word, PowerPoint, etj.);
- Kandidatët kërkohej të kenë vetiniciativë për zhvillim të mëtutjeshëm të departamentit.

Referencat janë të domosdoshme dhe duhet të dërgohen me CV.

Dorëzoni CV-në tuaj në E-mail adresën: info@scaak.org

Për pozitën: **Zyrtar i Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde (DMCPS)**

CV-të i pranojmë deri me 16.09.2024

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.